



**Republika e Kosovës – Republika Kosova**  
*Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa*  
*Izborni Panel za Žalbe i Predstavke*

**Anr. 193 /2012**

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Ymer Hoxha kryesues, Xhevdet Abazi dhe Muhamet Rexha anëtarë, duke vendosur përkritazi me ankesën e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), dega në Kaçanik, paraqitur kundër simpatizuesit të subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), Rexhep Luma, për shkak të ndikimit në votues, gjatë procesit të votimit, për Zgjedhjet e Jashtëzakonshme për Kryetar të Komunës së Kaçanikut, në seancën e panelit të mbajtur me 21.06.2012, mori këtë:

### **VENDIM**

**Refuzohet** si e pabazuar ankesa e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), dega në Kaçanik.

### **Arsyetim**

PZAP-i, me datën 18.06.2012, ka pranuar një ankesë nga subjekti politik LVV, me të cilën pretendohet se me datën 17 Qershor 2012, rreth orës 12:25 në Qendrën e Votimit (QV) 0701D, në Kaçanik, një person me emrin Rexhep Luma, ka qëndruar në oborrin e shkollës, duke bërë presion tek qytetarët që të votojnë për subjektin politik PDK. Parashtruesi i ankesës thekson se në këtë rast e ka raportuar Bujar Burniku, i cili në atë kohë ka shkuar për të votuar me familje. Parashtruesi i ankesës pretendon se ka pasur shkelje të nenit 177 të Kodit Penal, dhe nenit 4 të Rregullës Zgjedhore Nr.11/2009.

Parashtruesi i ankesës nuk i ka bashkangjitur ankesës asnjë dëshmi.

PZAP, me datën 19.06.2012, përmes postes elektronike, ka kërkuar nga stacioni policor në Kaçanik, raportin policor për ankesën Anr. 193/2012, lidhur me verifikimin e pretendimeve ankimore për ankesën në fjalë. Raportin policor, PZAP e ka pranuar në po të njëjtën datë, në të cilin theksohet se: Me datë 17.06.2012, zyrtarë policorë, të cilët kanë qenë të caktuar në Qendrën e Votimit Nr. 0701D, në shkollën e mesme “Skënderbeu”, në Kaçanik kanë kontaktuar me menaxherin e kësaj Qendre, dhe nuk ka pasur asnjë ankesë apo problem, me tutje në raportin policor ceket se në orët e pasdites fluksi i votueseve ka qenë më i madh, mirëpo çdo gjë ka qenë në rregull.

PZAP-i, pasi që shqyrtoj dhe analizoi shkresat e lëndës gjeti se:

### **Ankesa është e pabazuar**

Në pretendimet ankimore të subjektit politik LVV, se një person me emrin Rexhep Luma ka bërë presion tek qytetarët që të votojnë për subjektin politik PDK, në QV 0701D në Kaçanik, nuk qëndrojnë, për arsye se parashtruesi i ankesës nuk i ka bashkangjitur ankesës asnjë dëshmi me të cilën do të vërtetohej se ka pasur ndikim tek votuesit, andaj PZAP-i, duke u bazuar në raportin policor, të lartë përmendur si dhe në shkresat e lëndës gjeti se pretendimet ankimore në ankesë nuk qëndrojnë për faktin se pretendimet e tilla nuk janë të bazuara, prandaj një pretendim i tillë i ankesës u vlerësua si i pabazuar, në kuptim të nenit 115.1 lidhur me nenin 118 paragrafi 1 të LZP-së, lidhur me ankesën e lart përmendur u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi

PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i, në rast se gjoha e përfshirë është më e lartë sesa pesëmijë (5, 000) Euro ose në rast se çështja prek një të drejtë themelore.*

### **Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia në Prishtinë**

Anr. 193/2012 më datën 21.06.2012.

**Kryesuesi i Panelit  
Ymer Hoxha**

